



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 07/2025

I Mbajtur në takimin e VII-të të rregullt të KK-së me datën 31.07.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VII-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2025;
5. Propozim – Vendim për shkëputjen e Marrëveshjes së Bashkpunimit me Agjensinë për Zhvillimin Rajonal – Lindje “AZHR” të datës 16.12.2008, në mes komunave duke përfshirë edhe Komunën e Ferizajt;
6. Propozim –Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr.01. Nr.109 të datës 30.09.2019, i plotësuar – ndryshuar sipas Vendimit me Nr. 01.Nr. 22 të datës 28.03.2025;
7. Propozim –Vendim për aprovimin e memorandumit të bashkëpunimit me OJQ-të, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Shtëpia Ime” – Ferizaj;
8. Propozim – Vendim për pezullimin e Vendimeve me Nr.01. Nr. 48, 49,50,51,52,53,56 të datës 30.05.2025 dhe anulimin e Vendimit me Nr.01.Nr. 55 të datës 30.05.2025;

9. Propozim – Vendim për Subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik;
10. Pyetje dhe kërkesa dhe
11. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit pasi përshëndeti të pranishmit për pjesëmarrje theksoi që edhe në bazë të materialeve që keni marrë propozoj rendin e ditës të lartcekur.

Pyeti nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës dhe pasi spati kaloi me 32 vota për, 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi pyeti nëse dikush ka vërejtje rreth procesverbalit dhe pasi nuk pati u miratua me 32 vota për, 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi sa i përket pikës së 4-të që ishte Raporti financiar, në mungesë të drejtores ia kaloi fjalën Drejtorit Sabri Murseli, i cili e lexoi në pika të shkurtra këtë raport dhe nuk pati të interesuar për diskutim.

Sa i përket pikës së 5-të fjalën e mori Balton Dërguti, i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kjo pikë e rendit të ditës ka ardhë me kërkesë të Drejtorisë, pasi që e kemi parë të arsyeshme që të mos jemi pjesë e kësaj marrëveshje për shkak se paguajmë 9,500.00 euro në vit dhe nuk marrim asnjë shërbim, realisht pasi që Ferizaj në atë kohë kishte mbetur nën Regionin e Gjilanit dhe tani ekzistojnë 2 zyrtarë që punojnë në Komunën e Gjilanit, e që me i thirr sot që vijnë, ne si drejtori kemi bërë kërkesë, meqenëse Ferizaj është tani regjion të themelohet në qytetin tonë dhe deri të themelohet propozoj të shkëputet.

Verona Isaku pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që prej Vitit 2008-2025 bëhen 17 vite nga 9,500.00 euro në vit dëmi që i shkaktohet buxhetit të Ferizajt është 160 mij euro, po i konsiderojmë të avulluara d.m.th. del që jemi kanë të pa aft me shku me kërku llogari nga ta, drejtor kush merr përgjegjësi për këto mjete që s'kemi përfitu kurgja, cili do pushtet që u kanë, e kanë pagu këtë tarifë, a muajm me kërku llogari pasi që Komuna Ferizajt që sa vjet është top për buxhet, top për financa dhe ky vendim që ka ardh sot u dasht mu ba shumë ma herët.

Balton Dërguti, nuk është kurrë jashtëligjshëm me qenë ende anëtarë në këtë organizatë, ajo që pse po tërheqkemi është që po e konsiderojmë jo profitabile dhe për këto 4 vite sa jam kam konsideru që është i pa nevojshëm.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që unë pe kuptoj pak njëfarë forme të presionit na spo paguajmë deri sa të hapet dhe pasi të hapet e bëjmë prap.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që nuk o pune presioni, ministria është e sigurt që nëse ka fol me MZHR, so puna për 2 muaj pasi kemi prit që sa pse mos t'presim edhe pak.

Ibrahim Hyseni pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që unë e di kur u formu, mirëpo atëherë ska mujt mu formu në Ferizaj pasi s'kemi qenë regjion dhe unë mendoj që so që s'kem përfitu, pasi pas këtij viti janë bërë disa projekte, mirëpo ndërprerja e kësaj nuk o najfar shume pasi që mund të përfitojmë shumë, mendoj që ish kanë mirë me qenë edhe në Ferizaj.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi që unë pe di që në fund të mandatit drejtori e ka pa që po i shkaktohet dëm, ndërsa drejtorët e ma hershëm s'paskan ba kurr gjë veç i kanë marrë qato rroga, drejtor çka janë kanë përfitimet tona për këtë, çka nëse ministria ta kthen kundërligjshëm.

Xhavit Zariqi edhe unë po du mi than 2-3 fjalë, unë e di kur u themelu dhe realisht ka qenë kërkesë e BE-së për të bashkëpunu me komunat regjionale, s'pajtohna me drejtorin që komuna ska përfitu kurr gjë pasi komuna ka ba bashkëpunime me komuna dhe qëllimi ka qenë për me hartu projekte të përbashkëta e që kanë qenë projekte nga OJQ-të e huja, dhe njëherit kur Ferizaj u ba regjion ka qenë mirë mu ndërpre dhe duhet të bëhet prapë.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë dhe kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6 të rendit të ditës dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Sabri Murseli, i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që ky propozim ka të bëjë me përmirësimin e vendimit për pensionist pasi që drejtoria heziton t'i paguaj 4 qira për shtëpi të pensionistëve dhe si rrjedhojë duhet të korrigjohet, pasi spati të interesuar për diskutim kjo pikë kaloi me 31 vota për, 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 7-të the fjalën e morri Sabri Murseli i cili theksoi që kjo pikë ka të bëjë memorandumit e bashkëpunimit pasi ministria njëherë naj ka kthy të pa ligjshëm pasi kemi destinu ndërsa tash vetëm e kemi paraqit marrëveshjen e bashkëpunimit dhe i kemi caktuar një lokacion, ndërsa rastet do t'i procedon; organizata, gjykata me QPS.

Pasi spati të interesuar për diskutim kjo pikë kaloi me 32 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 8-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Sabri Murseli, i cili theksoi që kemi të bëjmë me pezullimin e vendimeve pasi ministria ka kërku me përjashtim të vendimit 55 ku pala e ka tërëhekur kërkesën dhe ky vendim propozohet të anulohet.

Amir Rexhepi, drejtor te ky vendimi 55, është votu pse mu anulu, mos e ka ftu njakush e ka detyru me u tërëhej. Kjo pikë kaloi me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi piken e 9-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Alberton Sahiti i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se kemi vendosur të subvencionojmë transportin ashtu si e lejon edhe ligji d.m.th. për transport urban dhe urbano periferik dhe kemi dy subvencione, ku për transport urban është 0.50 cent, ndërsa për urbao periferik çmimi do të jetë 0.35 dhe kemi paraparë disa kategori në transport urban falas si janë nxënës, invalid e kategori të dala nga lufta, ndërsa në atë urbano perfierik do të jetë 30% zbritje dhe këtë model e ka edhe Prishtina, andaj besoj që do të del mirë.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që edhe në KPF kemi diskutu që me ardhë me diskutime të karta, pasi në këtë propozim nuk caktohen këto gjana, meno që u ba sikur aj drejtori i kalum, me ato rrethat e vogël pa e ditë për çka e saktë, nëse e formon komisionin u dashtë

ma herët, e jo njëherë me miratu, tani me formu komision sje t'i drejtor mi ndihmu kompanive qysh këta që e kanë marrë tenderin tash po punojnë me humbje në këtë formë s'duhet me kalu ose duhet mu shty.

Flamur Istrefi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që sot diskutojmë për subvencionim të transportit urban dhe urbano periferik dhe ky duhet ta potencoj që nuk është një sukses, por një rezultat i një dështimi të planifikuar, pse dështim pasi që janë marrë vendime të gabuara pa analizë të duhur kemi ndërtuar Stacion të autobusëve në dalje të qytetit, larg qytetarëve, jashtë rrjedhës së nevojave të qytetarëve, pasi u kuptu që është larg, kemi vendos për transport urban dhe normalisht që po përballen me situatë kaotike, pasi ska pritore presin qytetarët në shi, e në diell nuk ka rrugë si duhet, nuk ka sinjalistikë dhe ska kushte bazike, që ky sistem të funksionojnë siç duhet dhe cili është rezultati i kësaj, operatorët ekonomik nuk mund ta mbaj orarin, qytetarët presin në diell e shi, po paramendone 400 mijë euro jo për ta përmirësua shërbimin po për ta mbajtur në këmbë, diçka që është ndërtuar gabim, ndërsa me këto mjete do të mund të ndërtonim shumë gjana të mira si është ndriçim publik, ndonjë park për fëmijët që ende luajnë në baltë.

Të nderuar mos e mbuloni një gabim me ndonjë faturë tjetër, pasi po u subvencionua kjo, do të kërkojmë llogari, ju faleminderit.

Verona Isaku pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që po më doket në Komunën e Ferizajt diqysh po bahen punët pak si prap, unë kur hypi prej Nikadinit paguj 0.30 cent edhe komuna nja 0.35 cent bahet 70 cent, ndërsa prej Ferizaj-Prishtinë mbahet 1.5 euro në krejt Prishtinën 0.80 cent. Ky as s'është subvencionim edhe po ja japim 400 mijë euro privatit, s'jemi na mos me subvencionu po, aj kur ka apliku u dasht me mat mire a mund ja del se kështu sa herë te jete keq na mi dhanë pare për ashtu koka mire edhe unë me qel një firmë.

Ibrahim Hyseni pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që po shihet që so zgjidhje stacioni po ne të më tregon dikush ku dikun jashtë vendit janë mrena qytetit, unë kam qenë drejtor edhe e di qysh ka funksionu ma herët, tash kemi shume me shume vetura paramendoni me pas hy edhe gjithë ata autobusa mrena qytetit, qfar kaosi ish kriju, sa i përket shumës unë se di a është 400 mij, a sa është pasi drejtori theksoi që të formohet një komision, kush me pagu e kush mos me pagu, unë mendoj që kjo është zgjidhje e momentit, e di qe ska infrastruktur të duhur, mirëpo edhe ma herët bre ska pas vendndalje nëpër qytete, ky transport nuk o ma i miri po fillimi është i vështirë, mirëpo duhet me kalu nëpër këto gjana.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kemi para vetës subvencionimin e transportit urban dhe urbano periferik, neve kemi diskutu edhe në KPF dhe pak a shumë gjithë kemi qenë pro veç se kemi kërku kjaritime me shume dhe kemi pas brengje që këto subvencionime mund të jene të vogla duke pasur parasysh nevojën e madhe për këtë çështje. Ne si kuvend përderisa po i përcaktojmë vlerat, po i caktojmë edhe buxhetin se sa kemi mi nda për këtë kategori, sa i përket planifikimit si tha edhe kolega le t'na tregon dikush në qytete të mëdha ku ka stacion mrena qytetit edhe në Prishtinë është në periferi, tash Prishtina o tu mëndu me zhvendos stacionin, sa i përket subvencionimit lokal është një formë e mirë që përdoret edhe ne botën perëndimore, ne e përkrahim si ide, ky buxhet po ndahet me ju ndihmu qytetareve, operatorët kanë me kry shërbimin e qytetarit, janë përfituesit më të mëdhenjë, normalisht që me ndërrimin e lokacionit dikujve ju

kanë afër, dikujt ju ka largu stacioni, s'do me thanë pse krejt janë të pa kënaqur, mirëpo edhe atje ku u zhvendos nuk janë krejt të pa kënaqur ju faleminderit.

Besim Haziri, pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që s'pari Arian gabimi ma i madh i juaji është kur pi drejtohi Prishtinës, s'do me thanë që Prishtina e ka kështu edhe duhet krejt me pas, mundet edhe ajo me pas, po Brah prej nalti te poshtë t'i bane stacionin po banja infrastrukturën jo kështu prej kulmi te poshtë, su dashtë mi ba nënkalimet, kështu se u dashtë me ditë që duhet me hy autobusët aty s'ka kuptim kështu.

Ibrahim Hyseni, koleg shembujt për t'mirë duhet mi marrë, edhe për t'keq normal kështu që mendoj që gjitha komunat që e kanë jashtë qytetit e kanë mirë spo thamë që transporti o perfekt, so njësoj si një autobus ose 2 me qarkullu në qytet, e sikur me u fut 20 menjëherë në qytet.

Arian Imeri, une e mora shembull Prishtinën me tregu që kritikant si keni t'bazue po pse po doni me kundërshtu çdo nisëm të Ferizajt, ta përmenda Prishtinën që udhëhiqet nga LDK, përndryshe Prishtina ka shume shembuj që duhet me marrë në Ferizaj.

Amir Rexhepi, vendimin për subvencionim e merr kuvendi dhe kuvendi tregon që cilat kategori i lejon nga pagesa, po i banë kuvendi këto punë, se për atë arsye jemi zgjedhe edhe kryetari e ka gojë plot, ta mbështesim qytetarin, ta subvencionojmë, unë se di ka ki me fut në atë komision, duhet me kanë përfaqësues nga partitë politike, sa i përket stacionit s'mujna njëherë me ndërto, tani me menu qysh me funksionu, na pe shohim që stacioni ish mush plot ujë, se di unë a punë kryesi, a komuna se ka mbikëqyr operatorët, ata besoj e kanë të pa mundur me funksionu me këtë shumë edhe kanë me u detyru mu terheq, transformimet i përmendi Ariani, po ky ka shkakto kaos pasi qytetari pret vend, e pa vend, në një rrugë 50 herë ndalet autobusi pasi ska pritore, duhet me publiku një orar pasi qytetarët dalin presin vend e pa vend, shembujt duhet mi marrë kur janë të mirë, pse po kesh Brah, a so qashtu, a t'i pe lun rolin e parimorit, ju faleminderit.

Hatixhe Bungu Qerimi, pasi përshëndeti të pranishmit, sa i përket transportit urban, o tu pas probleme, po unë besoj që këtu ska ekspert dhe pajtohem me Drejtorin që të formohet një komision dhe t'ketë ekspert të fushës dhe të bëhet një analize e thellë se si rregullohet dhe cilat kategori mi liru nga pagesa dhe pasi të përfundohet kjo punë të vihet në kuvend, e më pas mund të diskutojmë.

Zekir Bytyqi, pasi përshëndeti të pranishmit, unë në parim jam për këtë iniciativë, shumë vende perëndimore transporti publik mbështet nga organet shtetërore, ndërsa forma të gjindet, një formë ma e mirë, pasi në km s'mundesh me identifiku saktë, ndërsa duke pas modalitete te mira do të ishte një zgjidhje, ndërsa një tarifë fikse do të ishte një zgjidhje e mire pasi një qytetar do të paguante 2 herë, andaj unifikimi i një bilete do te ishte një zgjidhje e mire.

Verona Isaku, unë propozoj që të shtyhet pasi komisioni t'i jep skjarimet e pastaj d.m.th. qaj komisioni që drejtori po thotë mu formu njëherë, qaj tani këtu me pru, unë pe shohë që s'është mirë, po s'jam eksperte me thanë qysh duhet mu ba, ndërsa shtetet e perëndimit duhet me ditë që funksionon ose me partneritet publiko-privat, dhe duhet me ba analiza, pasi në të ardhmen mund të ketë rritje të derivateve, e gjithçka tjetër.

Brahim Osmani, po lidhna me Prishtinën, ata kanë nda pare me miliona, me nda mjete me ble autobusa, ndërsa kjo te ne ka me funksionu veç deri sa të kryhen zgjedhjet, ndërsa për anëtarin e

AKR-së atje t'i kështu ke arrit edhe djalën me ba aksionar atje edhe vjen këtu na kallxon kush i ka qit ujë atje, dil me fakte kallëzo, se sa herë na kemi fol t'i ke dal, ke thanë dil me fakte fol, edhe unë jam për me shty për seance, se këto dallojnë shumë, çka t'i po thu me atë, çka neve kemi në material, faleminderit.

Lulzim Abazi, pasi përshëndeti të pranishmit theksoi, që mu dashtë me u ndërlidhë me këtë pikë të rendit të ditës, transporti urban në Ferizaj është një e arritur e madhe, ky transport ka fillu fillimisht në qershor ku është inaguru edhe fillimi me autobus të rinjë, në qytet si hap i parë i llojit të tij në vend, dhe në fillim ka qenë falas për qytetarët, deri në Shtator të 2025 do të filloj edhe linja b, drejtorja është në punim e sipër, për biletën falas, që do t'i ofrohen kategorive të ndryshme, sa i përket infrastrukturës, kemi bërë një stacion shumë modern në periferi të qytetit, sa i përket pritoreve, ato veçse kanë filluar dhe po punohet çdo ditë për t'i bërë si duhet, sa i përket përceptimit publik në bisedat që bëjmë e kanë konsideru shumë të nevojshëm d.m.th. Kryetari Aliu i ka besu kësaj, si përmbledhje transporti urban është arritje historike për qytetin, infrastruktura si pritoret etj., do të rregullohen dhe do të jenë shumë funksionale, është e vërtetë që gjërat të bëhen menjëherë të bijën në vend, mirëpo është duke u punu në atë drejtim dhe shumë shpejt do të bëhen, unë e përgëzoj edhe drejtorin për punën që është duke bërë, pasi trafiku brenda qytetit ka qenë konstant i bllokuar, tani për tani trafiku përjashtoj këtë sezonën e mërgatës, është më i ngarkuar ndërsa ditët tjera ne jemi të vetëdijshëm që ka qenë në rregull, faleminderit.

Lumnije Morina, pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që nga diskutimet e kolegëve parafolës na s'jemi tu fol për mënyrën e rregullimit, po jemi tu fol për subvencionim dhe mbështetje, po ajo që na ka ofru drejtori në material është i mangët, s'pari s'flitet për komision dhe deri sa jemi këtu po propozohet formimi, unë mendoj që aj komision u dashtë tanimë me qenë i formuar dhe me ardhë bashkë me material dhe mendoj që kjo pikë s'është e përgatitur mirë dhe duhet mu shty.

Amir Rexhepi, e mbështes plotësisht propozimin e znj.Lumnije dhe materiali të na vije komplet dhe jo kështu gjysmak.

Kryesuesi propozoj që kjo pikë të shtyhet për një seance tjetër dhe si e tillë u miratu me shumicë votash, ku 23 vota ishin për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Tek të ndryshme kryesuesi pyeti nëse ka dikush diçka, dhe fjalën e mori Drejtori Arbër Bytyqi i cili propozoj që të korrigjohet lista rezerve e emrave dhe kemi harruar që t'i fusim edhe këta 9 emra, andaj po i paraqes:

- | | |
|-----------------------|----------|
| 1. Parisi | – Rrugë; |
| 2. Veteranet e UÇK-së | – rrugë; |
| 3. Shaip Munishi | – rrugë; |
| 4. Haxhi Nazifi | – rrugë; |
| 5. Kadri Paloja | – rrugë; |
| 6. Sabri Brahimi | – rrugë; |
| 7. Pajazit Calaj | – rrugë; |
| 8. Zaim Delolli | – rrugë; |
| 9. Arif Rama | – rrugë. |

Kryesuesi pyeti nëse ndonjë nga anëtarët ka diçka për të shtuar dhe u hodh në kuvend kaloi me 22 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi pyeti nëse në pyetje dhe kërkesa ka dikush diçka për të shtuar pasi nuk pati kryesuesi e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi